

Muhammed Ibën Salih el-‘Uthejmin

RITUALI I  
**UMRES**



سلفي

**SELEFI.ORG**

Kurani dhe Suneti sipas kuptimit të Selefeve të ketij Umeti

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

# Ritualit i Umres

**Muhammed Ibën Salih el-'Uthejmin**

Umreja përfshin ihramin, tauafin, sa'jin dhe rruatjen ose qethjen e kokës.

Sa i përket ihramit, ai është nijeti i hyrjes në ritin e Umres dhe veshjen e rrobës së ihramit. Suneti për atë që do të bëjë umre është që të lahet i gjithi ashtu siç lahet nga xhunubllëku, të parfumosë kokën dhe mjekrrën me parfumin më të mirë që mund të gjejë, me 'uud (lloj parfumi) ose me ndonjë lloj tjetër. Atij nuk i bën dëm parfumi edhe nëse i mbetet, mbasi që e ka veshur ihramin, sepse ka ardhur në dy Sahihët, nga hadithi i 'Aishes - *radij-Allahu 'anha* -, e cila ka thënë se:

كَانَ النَّبِيُّ - صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ - إِذَا أَرَادَ أَنْ يُحْرِمَ تَطَيَّبَ بِأَطْيَبِ مَا يَجِدُ، ثُمَّ أَرَى وَيَبْصَرَ  
الْمِسْكَ فِي رَأْسِهِ وَ لِحْيَتِهِ بَعْدَ ذَلِكَ.

“Pejgamberi - *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* - nëse donte të vishte ihramin, parfumosej me parfumin më të mirë që kishte, pastaj e shikoja miskun se si vezullonte në kokën dhe në mjekrrën e tij mbasi që ishte parfumosur.”

Pra, gusli (larja e të gjithë trupit) është sunet qoftë si për burrat dhe për gratë, madje edhe për ato që janë me menstruacione apo me lehoni, sepse Pejgamberi - *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* - urdhëroi Esmanë, të bijën e 'Umejsit, kur ajo lindi Muhamed Ibën Ebij Bekrin në Dhul-Hulejfeh (mikati i Medines), në Haxhin e Lamtumirës, e urdhëroi duke i thënë:



اغْتَسِلِي وَاسْتَنْفِرِي بِثَوْبٍ وَاحِرٍ مِي.

“Merr gusl, vendos një copë rrobe poshtë (që të ndalosh rrjedhjen e gjakut) dhe hyr në ihram.”<sup>1</sup>

Pastaj, mbas marrjes gusl dhe parfumosjes, vishen rrobat e ihramit: për burrat është ridaja dhe izari, kurse gruaja vesh çfarë rrobe të dojë, vetëm që të mos dalë e zbukuruar, të mos vërë nikab, të mos veshë dorashka dhe të mbulojë fytyrën kur të jetë në praninë e burrave që nuk janë mahrem për të.

Pastaj fal namazin farz nëse është koha e farzit ose fal dy rekate me nijetin e sunetit të abdesit, me përjashtim të grave që janë me menstruacione ose lehoni.

Kur të mbarojë namazin hyn në ihram dhe thotë:

لَبَيْكَ عُمْرَةً، لَبَيْكَ اللَّهُمَّ لَبَيْكَ، لَبَيْكَ لَا شَرِيكَ لَكَ لَبَيْكَ،  
إِنَّ الْحَمْدَ وَالنَّعْمَةَ لَكَ وَالْمُلْكَ لَا شَرِيكَ لَكَ.

“LebjeKe umraten, lebjeKe Allahumme lebjeK, lebjeKe la sherijke leKe lebjeK, innel-hamde, uen-ni’ameteH, leKe uel-mulk, laa sherijke leK.”

**Përkthimi:** “T’u përgjigja me Umre! T’u përgjigja o Allah, t’u përgjigja! T’u përgjigja, e Ti s’ke asnjë ortak! T’u përgjigja! Me të vërtetë lavdet janë për Ty, kjo mirësi është nga Ty, pushteti është vetëm i Yti dhe Ti s’ke asnjë ortak.”

Kjo është telbija e Pejgamberit - *sallAllahu ‘alejhi ue sellem* -, e ndoshta ai ka shtuar në të:

<sup>1</sup> E ka transmetuar Muslimi, nga hadithi i Xhabirit.

## لَبَّيْكَ إِلَهَ الْحَقِّ لَبَّيْكَ.

“LebjeKe Ilahel-Hakki LebjeK.”

Përkthimi: “T’u përgjigja o i Adhuruari i Vërtetë, t’u përgjigja!”

Suneti për burrat është që ta ngrenë zërin kur thonë telbijen, sepse ka ardhur në hadithin e Sa`ib Ibën Khal-lad - *radij-Allahu ‘anhu* - se Pejgamberi - *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* - ka thënë:

أَتَانِي جِبْرِيْلُ فَأَمَرَنِي أَنْ أَمُرَ أَصْحَابِي أَنْ يَرْفَعُوا أَصْوَاتَهُمْ بِالْإِهْلَالِ وَ التَّلْبِيَةِ.

“Më erdhi Xhibrili dhe më urdhëroi që t’i urdhëroj Shokët e mi që ta ngrenë zërin kur bëjnë telbije.”<sup>2</sup>

Dhe sepse ngritja e zërit me telbijen është shfaqje e simboleve të Allahut dhe shfaqje e Teuhidit.

Kurse gruaja nuk e ngre zërin me telbijen dhe as me ndonjë dhikr tjetër, sepse nga ajo kërkohet që të mos ekspozohet.

Kuptimi fjalës së telbijes “*LebejeKe Allahumme lebjeK*”, domethënë: **Po të përgjigjem o Zot dhe po të bindem Ty**, sepse Allahu i Përsosur nga çdo e metë i thirri robërit e Tij që të bëjnë haxhin, i thirri me gjuhën e dy robërve të Tij të dashur, Ibrahimit dhe Muhamedit - *‘alejhimas-salatu ues-selam* -:

وَأَذَّنَ فِي النَّاسِ بِالْحَجِّ يَأْتُوكَ رِجَالًا وَعَلَىٰ كُلِّ ضَامِرٍ يَأْتِينَ مِنْ كُلِّ فَجٍّ عَمِيقٍ ٢٧ لِيَشْهَدُوا مَنَافِعَ لَهُمْ

“Thirri njerëzit për haxhillëk: ata do të vijnë në këmbë dhe me deve prej të gjitha viseve të largëta, që të dëshmojnë dobitë e tyre...”<sup>3</sup>

<sup>2</sup> E ka transmetuar Ahmed, Ebu Dauudi, Tirmidhiu, Nesaiu dhe Ibën Maxheh.

<sup>3</sup> el-Haxh, 27-28

E nëse ai që do të veshë ihramin druhet se mos nuk e plotëson dot ritualin e umres nga ndonjë pengesë, siç është sëmundja apo ndonjë gjë tjetër, është sunet që ai të vërë kusht në nijetin e tij dhe të thotë kur bën nijetin:

إِنْ حَبَسَنِي حَابِسٌ فَمَحِلِّي حَيْثُ حَبَسْتَنِي.

“In habesenij habisun femehil-lij hajthu habesetnij.”

Domethënë: nëse më ndalon diçka nga plotësimi i ritualit, qoftë sëmundje apo vonim apo ndonjë gjë tjetër, atëherë unë dal nga ihrami nga ajo gjë. Sepse Pejgamberi – *sallAllahu 'alejhi ue sellem* – hyri tek Duba'ah Bint Zubejr dhe i tha:

لَعَلَّكَ أَرَدْتَ الْحَجَّ؟

“Mos doje të bëje haxhin?”

Ajo tha:

وَاللَّهِ مَا أُجِدُّنِي إِلَّا وَجِعَةً

“UAllahi e ndjej veten të dobët nga sëmundja.”

Ai tha:

حُجِّي وَاسْتَرَطِي وَ قُولِي: اللَّهُمَّ مَحِلِّي حَيْثُ حَبَسْتَنِي.

“Hyri në ihram për të bërë haxhin dhe vendos kusht dhe thuaj: *Allahumme, mehil-lij hajthu habesetnij.*”

Dhe tha:

إِنَّ لَكَ عَلَى رَبِّكَ مَا اسْتَنْتَيْتَ.

*“Dhe çdo kusht që ti vendos do të jetë i pranuar nga Zoti yt.”<sup>4</sup>*

Ama kush nuk druhet nga ndonjë pengesë që mund ta ndalojë nga plotësimi i ritualit, atëherë s’ka përse të vendosë kusht, sepse Pejgamberi – *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* – kur ka hyrë në ihram nuk ka vendosur kusht. Ai ka thënë:

لَتَأْخُذُوا عَنِّي مَنَاسِكُمْ.

*“Merrini nga unë ritualet tuaja (të Haxhit dhe Umres) që do të bëni.”<sup>5</sup>*

Dhe ai nuk dha urdhër të përgjithshëm për çdo njeri që të vendosë kusht, porse ai urdhëroi Duba’ah Bin Zubejr për shkak të sëmundjes që kishte ajo dhe frikës se mos nuk e plotësonte dot ritualin e Haxhit që do të bënte.

Gjithashtu, ai që ka hyrë në ihram duhet ta thotë sa më shumë telbijen, sepse ajo është simboli shprehimor i ritualit të Haxhit dhe Umres, sidomos kur ndryshojnë gjendjet dhe kohët, si për shembull kur ngjitesh në vende të larta apo kur zbret në vende të ulta apo kur vjen nata ose dita, ose kur do të bësh ndonjë gjë të ndaluar apo haram, etj.. Ai vazhdon me telbijen në Umre që kur hyn në ihram e deri kur të bëhet gati që të fillojnë tauafin. Kurse në haxh fillon me telbijen që kur hyn në ihram e deri kur bëhet gati që të gjuajë gurët në *Xhemratul‘Akabeh*, ditën e Bajramit.

<sup>4</sup> Hadith sahih, muttefekun ‘alejhi.

<sup>5</sup> E ka transmetuar Muslimi.

E nëse i afrohet Mekkes, është sunet që të lahet i tëri meqë do të hyjë në të, nëse e ka të lehtë që të lahet, sepse Pejgamberi – *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* – lahej i tëri kur hynte në Mekke.

Është transmetuar nga 'Abdullah Ibën 'Umer – *radij-Allahu 'anhuma* – se ai ka thënë: “Pejgamberi – *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* – kur hynte në Mekkeh, hynte nga rruga e sipërme që është në Bat`ha, e kur dilte, dilte nga rruga e poshtme.”<sup>6</sup>

Nëse haxhiu e ka të lehtë që të hyjë prej nga ka hyrë Pejgamberi – *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* – dhe të dalë që andej nga ka dalë ai, atëherë kjo është më e mirë.

Dhe kur të mbërrijë në Xhaminë e Haramit (në Qabe), ai duhet të hyjë në të me këmbën e djathtë dhe të thotë:

بِسْمِ اللَّهِ وَالصَّلَاةِ وَالسَّلَامِ عَلَى رَسُولِ اللَّهِ، اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي ذُنُوبِي وَاْفْتَحْ لِي أَبْوَابَ رَحْمَتِكَ،  
أَعُوذُ بِاللَّهِ الْعَظِيمِ وَبِوَجْهِهِ الْكَرِيمِ وَبِسُلْطَانِهِ الْقَدِيمِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ.

“Bismillah, ues-salatu ues-selamu 'ala Rasul-Ilah. Allahumme-gfirlij dhunuubij ueftah lij ebuabe rahmetiK. E'uudhu bll-lahi el-'Adhiim, ue bi Uexh`hiHi el-Keriim, ue bi SultaniHi el-Kadiim, mineshejtaniirr-raxhiim.”

Përkthimi: “Me Emrin e Allahut, qoftë lavdërimi dhe paqja mbi të Dërguarin e Allahut. O Allah, falmi gjynahet e mia dhe hapmi dyert e Mëshirës Tënde. Mbrohëm me Allahun Madhështor, me Fytyrën e Tij Fisnike dhe me Fuqinë e Tij të Përherëshme, nga shejtani i mallkuar.”

<sup>6</sup> E ka transmetuar Bukhari dhe Muslimi.



Ai duhet të hyjë me përvullje, nënshtrim dhe madhërim për Allahun – ‘Azze ue Xhel-le – dhe duke kujtuar mirësinë që i ka dhënë Allahu, që ia bëri të lehtë mbërritjen në Shtëpinë e Tij të Shenjtë.

Pastaj shkon drejt Qabes, duke u drejtuar nga Guri i Zi, për të filluar tauafin.

Ai nuk duhet të thotë: “Bëra nijet për tauafin”, sepse kjo nuk është transmetuar nga Pejgamberi – *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* – dhe sepse nijeti e ka vendin në zemër.

Pastaj e prek Gurin e Zi me dorën e djathtë dhe e puth nëse e ka të lehtë. Këtë e bën si madhërim për Allahun – ‘Azze ue Xhel-le – dhe për të pasuar të Dërguarin e Allahut – *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* –, e jo duke besuar se Guri i Zi të bën dobi apo të dëmton, sepse në të vërtetë dëmi dhe dobia janë veçse nga Allahu – ‘Azze ue Xhel-le –.

Është transmetuar nga Prijësi i Besimtarëve, ‘Umer Ibnul-Khattab – *radij-Allahu 'anhu* – se kur e ka puthur Gurin e Zi, ai ka thënë:

إِنِّي لَأَعْلَمُ أَنَّكَ حَجَرٌ لَا تَضُرُّ وَلَا تَنْفَعُ، وَلَوْ لَا أَنِّي رَأَيْتُ رَسُولَ اللَّهِ – صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ –  
يُؤْبِقُكَ مَا قَبَّلْتُكَ.

“Me të vërtetë unë e di që ti je një gur që as të bën dëm e as të bën dobi, dhe po të mos e kisha parë të Dërguarin e Allahut – *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* – duke të të puthur, unë s’do të të kisha puthur.”<sup>7</sup>

E nëse nuk e ka të lehtë që ta puthë, atëherë e prek me dorë dhe e puth dorën, sepse tek dy Sahihët ka ardhur hadithi i Ibën ‘Umerit – *radij-Allahu 'anhu* –, se ai e preku Gurin e Zi me dorën e tij dhe pastaj puthi dorën e tij dhe tha:

<sup>7</sup> E ka transmetuar Ahmedi, Bukhari, Muslimi, Ebu Dauudi, Nesaiu, Tirmidhiu dhe Ibën Maxheh.


مَا تَرَكْتُهُ مُنْذُ رَأَيْتُ النَّبِيَّ - صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ - يَفْعَلُهُ.

“Nuk e kam lënë këtë gjë qëkur e kam parë ta bëjë Pejgamberi – *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* –.”


E nëse nuk e ka të lehtë as prekjen e tij me dorë, atëherë nuk duhet që t'i shtyjë njerëzit, sepse shtyrja e lëndon atë dhe i lëndon edhe të tjerët, e ndoshta shkaktohet edhe dëm, i ikën frikrespekti dhe e nxjerr tauafin nga qëllimi për të cilin u urdhërua, që është adhurimi i Allahut. Madje ka të ngjarë që ai të thotë fjalë të kota, të debatojë e të grindet.

Atij i mjafton që të ngrejë dorën në drejtim të Gurit të Zi, edhe nëse është larg tij. Ka ardhur në hadithin që ka transmetuar Bukhari nga Ibën 'Abbasi – *radij-Allahu 'anhuma* – se Pejgamberi – *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* – bëri tauafin në Qabe i hipur mbi deve, dhe sa herë që vinte tek këndi (i Gurit të Zi), e ngrinte dorën drejt tij. Kurse në një transmetim tjetër ka ardhur se: ai bënte me shenjë drejt tij me diçka që e mbante në dorë dhe thoshte “*Allahu Ekber*”.

Pastaj, fillon tuafin nga krahu i djathtë, kurse Qabja është në krahun e majtë.



Kur arrin tek Këndi i Jemenit, e prek atë me dorë nëse e ka të lehtë, por pa e puthur. E nëse nuk e ka të lehtë, nuk duhet të ngjeshet me turmën.



Ai s'duhet të prekë asgjë tjetër përveç Gurit të Zi dhe Këndit të Jemenit, sepse këta të dy janë që nga themelet që vendosi Ibrahim, dhe sepse Pejgamberi – *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* – nuk ka prekur asnjë tjetër veç tyre.

Ka transmetuar Imam Ahmedi nga Muxhahidi, nga Ibën 'Abbasi, se ai bëri tauafin në Qabe bashkë me Mu'auijen, dhe Mu'auija filloi të prekte të gjitha këndet. I tha Ibën 'Abbasi: “Përse i prek këto dy këndet, ndërkohë që i Dërguari i Allahut – *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* – nuk i prekte?” I tha Mu'auija: “Nuk ka gjë që duhet të lihet nga Qabja.” I tha Ibën 'Abbasi:

لَقَدْ كَانَ لَكُمْ فِي رَسُولِ اللَّهِ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ

“Me të vërtetë, ju keni tek i Dërguari i Allahut shembullin më të mirë.”<sup>8</sup>

<sup>8</sup> El-Ahzab, 21.

Atëherë tha Mu'auija: “Të vërtetën the!”

Dhe ai duhet të thotë midis Këndit të Jemenit dhe Gurit të Zi:

رَبَّنَا آتِنَا فِي الدُّنْيَا حَسَنَةً وَفِي الْآخِرَةِ حَسَنَةً وَقِنَا عَذَابَ النَّارِ ٢٠١

“Rabbenaa aatina fid-dunia haseneten ue fil-akhirati haseneh, ue kinaa ‘adhaben-naar.”

“O Zoti ynë na jep mirësi në këtë dynja dhe në botën tjetër, dhe na ruaj nga dënimi i Zjarrit.”<sup>9</sup>

Sa herë që kalon tek Guri i Zi, vepron njësoj siç veproi më parë dhe thotë “**Allahu Ekber**”. Dhe gjatë gjithë tauafit thotë çfarë dhikri apo lutje apo pjesë nga Kur’ani të dojë sepse tauafi në Qabe, ecja midis Safas dhe Meruas dhe gjuatja e gurëve (tek Xhemaratet në Mina) janë ligjëruar për t’i bërë dhikër Allahut.

Suneti për burrat në këtë tauaf – kam për qëllim tauafin sapo mbërrin në Mekkeh – është që të bëhet “*Idtiba’a*” në të gjithë tauafin dhe të ecet me “*raml*” në tre rrotullimet e para, por jo në katër rrotullimet e fundit.



<sup>9</sup> El-Bekarah, 201.

“El-Idtiba’a” është nxjerrja e shpatullës së djathtë duke e ulur mesin e ridasë (rrobës së sipërme) nën sqetull dhe të dyja anët e ridasë i hedh mbi supin e majtë.

Kurse “err-Rraml” është ecja e shpejtë me hapa të shkurtër.

Tauafi ka shtatë rrotullime, duke e filluar që nga Guri i Zi e duke e përfunduar po aty.


Tauafi nuk është i saktë nëse bëhet brenda “Hixhrit të Ismailit”.

Kur të plotësojë shtatë rrotullime, atëherë shkon drejt “Mekamu Ibrahimit” dhe thotë:

وَاتَّخِذُوا مِنْ مَّقَامِ إِبْرَاهِيمَ مُصَلِّينَ

“Uet-tekhidhuu mim-Mekami Ibrahimie musal-laa.”

“Bëjeni Mekamin e Ibrahimit vendfalje!”<sup>10</sup>



<sup>10</sup> El-Bekarah, 125.



Pastaj i fal dy rekate mbas tij, nëse është e mundur afër tij, e nëse jo larg tij. Në rekatin e parë lexon mbas Fatihasë suren “*Kul jaa ejjuhel-kafiruun.*” Kurse në rekatin e dytë lexon mbas Fatihasë suren “*Kul HuuAllahu Ehad.*”

Pastaj kthehet prap tek Guri i Zi dhe e prek me dorë nëse e ka të mundur, përndryshe as nuk e bën me shenjë duke ngritur dorën në drejtim të tij.

Pastaj del në drejtim të Sa'jit për të ecur midis Safas dhe Meruas. Kur të afrohet tek Safa reciton ajetin:


إِنَّ الصَّفَا وَالْمَرْوَةَ مِن شَعَائِرِ اللَّهِ

“Innes-Safa uel-Merueete min she'aairIlah.”

“Me të vërtetë Safa dhe Merua janë prej simboleve të Allahut.”<sup>11</sup>

Dhe nuk e lexon këtë ajet në asnjë herë tjetër përveç se në këtë rast.

Pastaj ngjitet në Safa derisa të shohë Qaben.



<sup>11</sup> El-Bekarah, 158.

Atëherë drejtohet kah Qabja, i ngre duart lart, e lavdëron Allahun dhe lutet me çfarë duaje që dëshiron. Duaja që ka bërë Pejgamberi – *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* – këtu është:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ.  
لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ، أَنْجَزَ وَعَدَهُ وَنَصَرَ عَبْدَهُ وَهَرَمَ الْأَحْزَابَ وَحْدَهُ .

“La ilahe il-lAllahu uahdeHu la sherijke leHu, leHul-mulku ue leHul-hamdu, ue Huue ‘ala kulli shej`in Kadiir. La ilahe il-lAllahu uahdeHu, enxheze ua`deHu, ue nasara ‘abdeHu, ue hezemel‘ahzabe uahdeHu.”

Këtë e përsërit tre herë dhe midis tyre bën dua.

Pastaj zbret nga Safa duke ecur drejt Merua-s, derisa të mbërrijë tek shtylla jeshile. E kur të mbërrijë atje, duhet të nxitojë sa më shumë që të ketë mundësi, nëse e ka të lehtë, pa u dëmtuar nga kjo, derisa të mbërrijë tek shtylla jeshile e dytë.<sup>12</sup> Pastaj vazhdon të ecë normalisht derisa të mbërrijë në Merua dhe të ngjitet në të. Atëherë drejtohet me fytyrë kah Kibleja, ngre duart lart dhe thotë ashtu siç tha në Safa.

Pastaj zbret nga Merua për të shkuar në Safa, duke ecur në distancën ku duhet të ecet dhe duke shpejtuar në distancën ku duhet shpejtuar. Pastaj ngjitet në Safa, drejtohet me fytyrë kah Kibleja, ngre duart lart dhe thotë ashtu siç tha herën e parë. Kurse në ecjen që ka në vazhdim thotë çfarë dhikri apo pjesë nga Kur’ani apo lutje të dojë.

Ngjitja lart mbi Safa dhe mbi Merua dhe vrapimi mes dy shenjave treguese (me drita jeshile) janë të gjith Sunet dhe nuk janë uaxhib (obligim).

<sup>12</sup> **Shënim i përkthyesit:** Tani e gjithë zona midis Safa-s dhe Merua-s ku duhet të nxitohet sa më shumë është bërë e gjitha me dritë jeshile dhe dallohet lehtë.

Nëse i plotëson shtatë ecje, nga Safa deri në Merua është një ecje dhe nga Merua deri në Safa është një ecje tjetër, atëherë vijon me rruajtjen e kokës – nëse është burrë – ose shkurtimin e flokëve. Mirëpo rruajtja është më mirë, përveç nëse do që të bëjë haxhin *temett'ue*<sup>13</sup> dhe e koha e haxhit është afër dhe atij s'mund t'i mbijnë flokët përpara tij, kështu që shkurtimi i flokëve është më mirë, që t'i mbeten flokët dhe t'i rruajë kur të bëjë haxhin, sepse Pejgamberi – *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* – i urdhëroi Sahabët e tij, kur mbërritën sabahun e ditës së katërt të muajit Dhul-Hixheh, që të dalin nga ihrami (mbasi që kryen umren) me shkurtimin e flokëve.

Kurse gruaja i pret flokët në çdo rast dhe nuk i rruan ato, porse pret vetëm majat e flokëve.

Është detyrë që të rruhet e gjithë koka, ngase i Lartësuari ka thënë:

مُحَلِّقِينَ رُءُوسَكُمْ

“...me kokë të rruajtura...”<sup>14</sup>

<sup>13</sup> **Shënim i përkthyesit:** Ka thënë Shejkh Ibën 'Uthejmini – *rahimehullah* – në përkufizimin e haxhit *temettuë*: “Ky është (haxhi) *temettuë*: që njeriu të hyjë në ihram që nga mikati për të bërë umren, dhe kur mbërrin në Mekkeh bën tauafin, sa'jin dhe qeth flokët, dhe atëherë del nga umreja e tij. Dhe kur të vijë dita e tetë (e Dhul-Hixhes), vesh ihramin për të bërë Haxhin e atij viti dhe pastaj del nga ihrami në ditën e Bajramit.” [Fet`h *Dhil-Xhelaali uel-Ikraam bi Sherh Buluug el-Meraam*, vëll.8/fq.107]

Dhe ka thënë në po të njëjtin vend: “Ky lloj është quajtur haxh *temettuë* sepse njeriu nuk privohet nga kënaqësitë mbas kësaj umreje deri në haxh. Domethënë, ai nuk privohet nga kënaqësitë kur mbaron umren dhe del nga ihrami, porse kënaqet me ato gjëra që ia ka lejuar Allahu. Pra, ai kënaqet me të gjitha ato gjëra që i kishte të ndaluara kur ishte në ihram, siç është veshja e rrobave, parfumosja, pastrimi, heqja e qimeve, po ashtu marrëdhëniet me bashkëshorten e tij etj..”

<sup>14</sup> El-Fet`h, 27.

Dhe sepse Pejgamberi – *sallAllahu 'alejhi ue sellem* – e rruajti të tërë kokën e tij dhe tha:

لَتَأْخُذُوا عَنِّي مَنَاسِكُمْ.

“Merrini nga unë ritualet tuaja (të Haxhit dhe Umres) që do të bëni.”<sup>15</sup>

Po ashtu, qethja e flokëve përfshin të gjithë kokën.



Dhe me këto veprime ai e përfundon umren dhe del plotësisht nga ihrami dhe i lejohet çdo gjë që i ishte ndaluar kur hyri në ihram.

<sup>15</sup> E ka transmetuar Muslimi.

## *Përmbledhje e riteve të umres:*

- 1 – Larja e plotë, ashtu siç lahesh nga kur je xhunub, si dhe parfumosja.
- 2 – Veshja e dy copave të ihramit, që janë: izari dhe ridaja për burrat, kurse gruaja veç ato çfarë të dojë nga rrobat e lejuara.
- 3 – Thënia e telbijes dhe vazhdimi me të deri në tauaf.
- 4 – Tauafi në Qabe me shtatë rrotullime, duke filluar që nga Guri i Zi dhe duke e përfunduar tauafin sërish tek ai.
- 5 – Falja e dy rekateve mbas Mekamit të Ibrahimit.
- 6 – Sa'ji (ecja) ndërmjet Safa-së dhe Merua-s, me shtatë ecje, duke e filluar nga Safa dhe duke e përfunduar në Merua.
- 7 – Rruajtja ose qethja për burrat, kurse për gratë shkurtimi (i majave të flokëve).

*28 Xhumad-el-Euel 1436 Hixhrij / 19 Mars 2015 Miladij*

*Përkthëu: Alban Malaj*

*'Auali, Mekkefih*